



# SIGURIA E FËMIJËVE NË INTERNET

# SIGURIA E FËMIJËVE NË INTERNET

Prishtinë, Qershor,  
2014

**Autorët:**

Besianë Musmurati  
Teuta Zymeri

**Editorët:**

Hamit Qeriqi  
Bedri Zymeri  
Liridon Latifi

**Implementuar nga:**

Qendra për studime të avancuara – FIT  
Eqrem Qabej, nr. 166  
10000 Prishtinë, Kosovë  
info@internetisigurte.org  
www.internetisigurte.org

**Koordinuar nga:**

Dhurata Nixha  
Save the Children

**Përkthimi dhe korrigjimi:**

Global Consulting & Development Associates LLC

**Dizajni, faqosja dhe shtypja:**

Envinion

**Botuar nga:**

Save the Children  
Gazmend Zajmi, nr. 01  
10000 Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0) 38 23 26 91  
Faks: +381 (0) 38 23 26 93  
Scik@savethechildren.org  
<http://Kosovo.savethechildren.net>

**© Qershor 2014 “Save the Children”**

Ky publikim është i mbrojtur nga e drejta e autorit, mund të kopjohet për qëllime edukative, por jo për shitje. Për çfarëdo lloj përdorimi duhet paraprakisht të merret leja nga botuesi. Mendimet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe jo domosdoshmërisht pasqyrojnë mendimet e organizatës Save the Children.

## **Për Qendrën FIT**

Qendra për studime të avancuara FIT (Qendra FIT) është një organizatë e pavarur joqeveritare e themeluar në vitin 2011. Stafi i saj profesional përbëhet nga profesionistë të fushave të ndryshme që kanë për synim të ngritin reputacionin për standardet e larta të punës cilësore dhe sasiore për hulumtimet.

## **Për Save the Children**

Save the Children është një organizatë e pavarur me fokus fëmijët dhe punon në rreth 120 vende të botës. Save the Children në Kosovë punon prej vitit 1997 duke realizuar programe të reagimit emergjent dhe zhvillimit në fushën e arsimit, mbrojtjes së fëmijëve dhe rregullimit të drejtave të fëmijëve në gjithë Kosovën.

## **Falënderime**

Falënderojmë të gjithë ata që morën pjesë në hartimin e këtij raporti dhe na ndihmuan gjatë gjithë kohës.

Në veçanti, falënderojmë Drejtoritë e Arsimit të komunave të Prizrenit, Mitrovicës, Prishtinës, Pejës, Ferizajit, Gjilanit dhe Gjakovës që mundësuan plotësimin e pyetësorit tonë në shtatë shkolla fillore. Gjithashtu falënderojmë edhe stafin e shkollave fillore Ibrahim Fehmiu (Prizren), Migjeni (Mitrovicë), Naim Frasheri (Prishtinë), Ramiz Sadiku (Pejë), Tefik Çanga (Ferizaj), Thimi Mitko (Gjilan) dhe Zekeria Rexha (Gjakovë) për ndihmën e dhënë gjatë plotësimit të pyetësorëve.

Në fund, falënderojmë fëmijët që e plotësuan pyetësorin tonë dhe prindërit që i lejuan fëmijët të marrin pjesë në këtë raport.



## PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....	9
HYRJE .....	11
Metodologjia.....	12
Kufizimet dhe sfidat.....	13
PËRDORIMI I INTERNETIT .....	14
Sa e përdorin fëmijët internetin? .....	14
Mënyra e qasjes në internet.....	16
Njohuria digjitale dhe masat e sigurisë .....	17
Përdorimi i (pa)mbikëqyrur i internetit .....	19
AKTIVITETET E FËMIJËVE NË INTERNET .....	21
Aktivitetet kryesore .....	21
Rrjetet Sociale .....	22
Video lojërat në internet.....	24
RREZIQET .....	26
Përmbajtja e papërshtatshme pornografike.....	26
Takimi me njerëz të rinj.....	29
Rreziqet tjera.....	33
Publikimi i të dhënave personale .....	33
Keqpërdorimi i të dhënave personale .....	34
SAJBËRDHUNA.....	36
Identifikimi i sajberdhunës.....	36
Format e sajberdhunës .....	38
Përballja me sajberdhunën .....	39
Efektet e sajberdhunës .....	41
REKOMANDIME .....	43
REFERENCAT .....	46

## LISTA E FIGURAVE

■ Figura 1: Përdorimi i internetit nga fëmijët dhe prindërit .....	14
■ Figura 2: Sa shpesh e përdorin fëmijët internetin? .....	15
■ Figura 3: Sa gjatë qëndrojnë fëmijët në internet në suaza ditore? .....	15
■ Figura 4: Pajisjet nga të cilat fëmijët e përdorin internetin .....	16
■ Figura 5: Ku e përdorin fëmijët internetin? .....	17
■ Figura 6: Sa ndihen të sigurt fëmijët gjatë përdorimit të internetit? .....	18
■ Figura 7: Identifikimi i përmbajtjes ilegale në internet.....	18
■ Figura 8: Aktivitetet e lejuara për fëmijët nga prindërit në internet.....	20
■ Figura 9: Fëmijët që kanë llogari në rrjete sociale në Kosovë dhe Evropë.....	22
■ Figura 10: Numri i shokëve që i kanë fëmijët në rrjete sociale .....	23
■ Figura 11: Fëmijët që luajnë lojëra në internet.....	24
■ Figura 12: Çfarë lojëra luajnë fëmijët në internet? .....	24
■ Figura 13: Fëmija ka parë imazhe me përmbajtje pornografike gjatë vitit të kaluar .....	27
■ Figura 14: Fëmija është shqetësuar pasi ka parë pamje seksuale në internet .....	27
■ Figura 15: Pajisjet nga të cilat janë parë përmbajtjet pornografike.....	28
■ Figura 16: Vendi nga i cili fëmijët shohin video me përmbajtje pornografike.....	28
■ Figura 17: Fëmija ka kontaktuar dikë të panjohur në internet, ose është takuar me të panjohur .....	30
■ Figura 18: Numri i njerëzve të panjohur që fëmijët i kanë takuar ballë për ballë .....	30
■ Figura 19: Fëmija ka qenë i shqetësuar pas takimit me person të panjohur .....	31
■ Figura 20: Numri i personave të panjohur që fëmijët kanë takuar dhe janë shqetësuar nga ky takim.....	32
■ Figura 21: Moshë e personave të panjohur që fëmijët kanë takuar dhe janë shqetësuar nga ky takim.....	32
■ Figura 22: Të dhënat personale të cilat fëmijët i postojnë në internet.....	34
■ Figura 23: Ngacmimet e fëmijëve përmes internetit ose ndonjë mënyre tjetër në vitin e fundit.....	37
■ Figura 24: Fëmija ka qenë i shqetësuar nga ngacmimi në internet .....	39
■ Figura 25: Me kënd ka biseduar fëmija pasi ka qenë i ngacmuar në internet?.....	41
■ Figura 26: Reagimi i fëmijëve nga përmbajtja në internet .....	42

## LISTA E TABELAVE:

■ Tabela 1: Ndërmjetësimi i mësuesve në sigurinë e fëmijëve në internet (në përqindje).....	19
■ Tabela 2: Aktivitetet e preferuara të fëmijëve në internet .....	21
■ Tabela 3: Fëmijët që kanë hasur në keqpërdorim të të dhënave personale në vitin e fundit (në përqindje).....	34
■ Tabela 4: Sa shpesh është ngacmuar fëmija në vitin e fundit? .....	37
■ Tabela 5: Mënyrat se si janë ngacmuar fëmijët përmes internetit.....	38
■ Tabela 6: Çfarë ka bërë fëmija pasi ka qenë i ngacmuar përmes internetit.....	40
■ Tabela 7: Karakteristikat shoqërore dhe psikologjike të fëmijëve .....	42





# PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

**D**uke pasur parasysh mungesën e hulumtimeve në Kosovë në fushën e sigurisë së fëmijëve në internet, ky raport ka për qëllim të hulumtoj se si fëmijët e përdorin internetin dhe të identifikoj rreziqet e mundshme në lidhje me aktivitetet online të fëmijëve. Ky raport krahasues në radhë të parë përshkruan sjelljen e fëmijëve në internet dhe më pas elaboron rreziqet që lidhen me përdorimin e internetit. Të dhënat janë mbledhur nga një pyetësor me 1.150 fëmijë të moshës 9-16 vjeç nga shtatë komunat më të mëdha të Kosovës.

Objektivi i përgjithshëm i këtij raporti është që të përshkruaj aktivitetet e fëmijëve në internet dhe të vlerësoj njohuritë e tyre në lidhje me çështjet e sigurisë në internet. Raporti përmban gjashtë kapituj: Hyrja, Përdorimi i internetit, Aktivitetet online, Rreziqet, Sajbërdhuna dhe Rekomandimet. Hyrja shpjegon në detaje qëllimin dhe metodologjinë e përdorur për hartimin e këtij raporti, ndërsa kapitujt pasues përmbajnë pjesën kryesore të informatave mbi aktivitetet kryesore të fëmijëve në internet dhe rreziqet potenciale.

Në fillim, raporti analizon se sa fëmijët e përdorin internetin, aktivitetet e tyre kryesore në internet, mënyrat e qasjes dhe njohuritë digjitale të fëmijëve. Më pas, raporti adreson rreziqet që lidhen me aktivitetet online siç janë: shikueshmëria e videove me përmbajtje pornografike, takimi me njerëz të rinj, keqpërdorimi i të dhënave personale dhe virusët e ndryshëm. Gjithashtu, raporti thekson format dhe efektet e sajbërdhunës si dhe mekanizmat që fëmijët përdorin për të përballuar ngacmimet në internet. Kapitulli i fundit paraqet konkluzionet e studimit dhe rekomandimet për akterët relevant siç janë fëmijët, prindërit, mësuesit, industria e telekomunikacionit dhe politikë-bërësit.

Gjetjet e studimit sugjerojnë se fëmijët në Kosovë janë përdorues shumë aktivë të internetit dhe kryesisht e përdorin atë për qëllime argëtuese dhe komunikim. Shumica e fëmijëve kanë raportuar se aktivitetet e tyre më të preferuara në internet janë rrjetet sociale, YouTube, dhe dëgjimi i muzikës. Ka mungesë të theksuar të përfshirjes nga prindërit dhe mësuesit në monitorimin dhe mbështetjen e fëmijëve në përdorimin e internetit dhe kështu çdo herë e më shumë fëmijët janë duke përdorur internetin në mënyrë të pavarur dhe pa mbikëqyrjen e të rriturve. Është bërë shumë e vështirë për të rriturit që të monitorojnë aktivitetet e fëmijëve në internet sidomos pasi që shumica e fëmijëve kanë raportuar që përdorin internetin privatisht, në dhomat e tyre apo përmes telefonave të mençur mobil.

Në përgjithësi, raporti vlerëson se përdorimi i internetit nga fëmijët në Kosovë duhet të forcohet dhe jo të kufizohet. Vetëdijesimi i shoqërisë për rreziqet e mundshme, përmirësimi i programeve për siguri në internet dhe njohja më e mirë e përdorimit të internetit nga familjet janë mënyra të duhura që mund të rezultojnë në përdorim më të mirë dhe më të sigurt të internetit nga ana e fëmijëve.



# HYRJE

**K**ohëve të fundit, shumica e fëmijëve fillojnë të kenë qasje në internet në moshë shumë të re. Përderisa numri i fëmijëve që përdorin internetin përmes pajisjeve të ndryshme elektronike është në rritje të vazhdueshme, edhe ekspozimi i tyre ndaj rreziqeve të ndryshme është mjaft i madh.

Nëse përdoret optimalisht, qasja në internet mund të ndihmojë fëmijët të mësojnë më shumë për botën dhe mund të shërbejë si një mjet i dobishëm për zhvillimin e tyre akademik dhe personal. Në anën tjetër, nëse nuk përdoret siç duhet ose nuk mbikëqyret nga të rriturit, qasja e fëmijëve në internet mund të rezultojë e dëmshme dhe paraqet rreziqe serioze fizike dhe psikologjike. Rreziku i abuzimit të fëmijëve në internet për shkak të mungesës së kontrollit nga prindërit dhe mësuesit e tyre është rritur në mënyrë dramatike sidomos me ardhjen e rrjeteve sociale. Inkurajimi i përdorimit të sigurt dhe të përgjegjshëm të internetit si dhe njohuritë mbi rreziqet potenciale janë hapa të rëndësishëm drejt ndërtimit të një platforme të menaxhimit të rrezikut për të mbajtur fëmijët të sigurt në internet.

Sipas Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijëve, fëmijët kanë të drejtë themelore “të drejtën për zhvillim” dhe “të drejtën për mbrojtje nga influencat e rrezikshme”. Në besojmë që ky raport do të informoj politikë-bërësit në Kosovë për rreziqet e mos respektimit të këtyre të drejtave themelore të fëmijëve, duke nënvizuar politikat të cilat në Kosovë janë neglizhuar për një kohë të gjatë.

Aktivitetet e dëmshme dhe të rrezikshme siç janë pornografia me fëmijë, krijimi i profileve të rrejshme në rrjete sociale, dhe aktivitete të tjera shpesh ndikojnë drejtpërdrejtë në zhvillimin mental të fëmijëve, dhe njëkohësisht rrezikon rritjen e sjelljeve të dhunshme të fëmijëve në shkollë. Duke pasur parasysh mungesën e hulumtimeve në këtë fushë në Kosovë, ky raport ka për qëllim të kuptojë se si fëmijët e përdorin internetin dhe të përshkruaj disa rreziqe të mundshme nga aktivitetet e tyre online.

Objektiv tjetër i këtij raporti është matja e sjelljes së fëmijëve në internet për të vlerësuar njohuritë e tyre në lidhje me çështjet e sigurisë në internet. Raporti trajton çështje të tilla si: si e përdorin fëmijët internetin në Kosovë, aktivitetet më të shpeshta në internet, njohuritë e përgjithshme digjitale, rreziqet e ndryshme siç janë shikimi i videove me përmbajtje të papërshtatshme, takimi me njerëz të rinj dhe sajberdhuna.

Fëmijët janë pasuria më e vlefshme e Kosovës pasi që ata përfaqësojnë të ardhmen e vendit tonë. Për më tepër, fëmijët janë anëtarët më të ndjeshëm të shoqërisë dhe mbrojtja e tyre nga krimi duhet të jetë prioritet për hartuesit e politikave. Për fat të keq, të njëjtat zhvillime teknologjike që i`u mundësojnë fëmijëve të fitojnë shumë njohuri për botën gjithashtu i lënë ata të pambrojtur ndaj shfrytëzimit dhe dëmtimit nga përdorimi i tyre. Raporti i mëposhtëm ka për qëllim të informojë fëmijët, prindërit, mësuesit, dhe hartuesit e politikave në Kosovë në lidhje me kompleksitetin dhe rreziqet nga aktivitetet online.

## Metodologjia

Ky është raport krahasues që në radhë të parë përshkruan sjelljen e fëmijëve në internet dhe më pas elaboron rreziqet që lidhen me përdorimin e internetit.

Të dhënat janë mbledhur nga një pyetësor me 1,150 fëmijë të moshës 9-16 vjeç nga shtatë komunat më të mëdha të Kosovës. Duke pasur parasysh mungesën e të dhënave për përdorimin e internetit në Kosovë, ne kemi zhvilluar një pyetësor i cili është dërguar në shtatë shkolla fillore. Për të marrë pjesë në këtë pyetësor janë përzgjedhur shkollat e mëposhtme: Ibrahim Fehmiu (Prizren), Migjeni (Mitrovicë), Naim Frashëri (Prishtinë), Ramiz Sadiku (Pejë), Tefik Çanga (Ferizaj), Thimi Mitko (Gjilan) dhe Zekeria Rexha (Gjakovë). Mostr përbëhet nga 1.150 nxënës të moshës 9-16 vjeç (klasat 5-9) nga shtatë komunat më të mëdha të Kosovës.

Përveç marrjes së lejes për të zhvilluar pyetësorin në shkolla nga Drejtoritë e Arsimit në Prizren, Mitrovicë, Prishtinë, Pejë, Ferizaj, Gjilan dhe Gjakovë ne kemi kërkuar që çdo fëmijë të ketë lejen nga prindërit për të marrë pjesë në pyetësor. Një leje paraprake është dorëzuar tek prindërit të cilët kanë autorizuar pjesëmarrjen e fëmijëve në pyetësor.

Janë zhvilluar dy lloje të pyetësorit për grupmosha të ndryshme. Pyetësori për fëmijët e moshës 9-12 vjeç (klasat 4-6) përmbante 47 pyetje me shumë zgjedhje, ndërsa ai për fëmijët e moshës 13-16 vjeç (klasat 7-9) përmbante 50 pyetje, duke përfshirë edhe 3 pyetje në lidhje me përmbytjen seksuale online.

Në mënyrë që të kemi përgjigje sa më të mira në pyetësor, stafi i Qendrës FIT i ka lexuar dhe shpjeguar me zë të lartë pyetjet në klasë. Fëmijët gjithashtu kanë pasur mundësinë të bëjnë pyetje (me zë të lartë ose individualisht) për çfarëdo paqartësi rreth pyetësorit. Kjo metodë është përdorur për të gjitha pyetjet në pyetësor.

- Është bërë një pilot pyetësor për të eliminuar/përmirësuar pyetjet më komplekse. Disa nga pyetjet janë modifikuar për të qenë më të thjeshta dhe më lehtë të kuptueshme. Pas pilot pyetësorit, janë shtuar më shumë udhëzime në disa pyetje.
- Në përpjekje për të krijuar një ambient sa më të relaksuar, pyetësorin e kemi zhvilluar në klasë me prezencën e mësuesit. Ne e kemi bërë të qartë se emrat e fëmijëve nuk do të përdoren, kështu që përgjigjet e tyre do të mbeten konfidenciale. Gjithashtu, ne kemi ofruar pije freskuese për të gjithë fëmijët të cilët morën pjesë në pyetësor.
- Për pyetjet më të ndjeshme, siç janë ato për shikimin e videove me përmbytje të papërshtatshme erotike, është dhënë shpjegim i detajuar.
- Për pyetjet që mund të konsiderohen si më të vështira apo të turpshme për t'u përgjigjur, fëmijëve u janë dhënë opsionet “nuk e di” ose “preferoj të mos përgjigjem”. Në përgjithësi, janë shfrytëzuar një numër i vogël i këtyre opsioneve; megjithatë, për qëllime etike ishte e rëndësishme që mundësitë e tilla të vihen në dispozicion.

## Kufizimet dhe sfidat

Janë bërë të gjitha përpjekjet që pyetësoni të ketë dizajn dhe administrim profesional në mënyrë që të paraqitet sa më mirë përdorimi i internetit nga fëmijët në Kosovë. Megjithatë, raporti ka kufizime të cilat duhet të merren parasysh gjatë interpretimit të të dhënave. Përveç kësaj, ka pasur disa sfida gjatë zbatimit të pyetësonit.

- *Kufizimet kohore* – duke pasur parasysh kompleksitetin e marrjes së lejeve nga Drejtoritë e Arsimit nëpër komuna, ka qenë e vështirë për ne që të kontaktojmë secilin Drejtor dhe secilin drejtor të shkollës. Është dashur të bëhen disa vizita paraprake nëpër secilin qytet në mënyrë që të sigurohen këto leje dhe të organizohet mbarëvajtja e pyetësonit. Gjithash-tu edhe marrja e lejes nga secili prind i fëmijëve që kanë marrë pjesë në pyetëson ka krijuar më shumë vështirësi se sa që pritej.
- *Norma e përgjigjes* – edhe pse norma e përgjigjes është e konsiderueshme, disa fëmijë të moshës 13-16 vjeç nuk e dërguan letrën për marrjen e lejes tek prindërit dhe kështu nuk morën pjesë në pyetëson. Kjo e zvogëloi normën e përgjigjes nga 1,500 respondent të planifikuar në 1,150 (apo 77 %).
- *Pyetjet indirekte* – ka pasur disa pyetje që për shkak të natyrës së tyre të ndjeshme është dashur të parashtrihen në mënyrë indirekte. Për shembull, pyetjet me përmbajtje erotike dhe sajbërdhunë janë përcjell me një paragraf shpjegues.
- *Konteksti shoqëror* – çdo pyetëson është pjesë e një konteksti shoqëror. Edhe pse çdo fëmijë është informuar që përgjigjet do të jenë plotësisht anonime, për shkak të presionit nga bashkëmoshatarë, fëmijët mund të kenë dhënë përgjigjen më të dëshirueshme.
- *Madhësia e mostrës* – edhe pse madhësia e mostrës është përfaqësuese e popullatës në aspektin e përfshirjes gjeografike, është e rëndësishme të ceket që pjesët rurale nuk janë përfshirë në mostër.


# PËRDORIMI I INTERNETIT

**P**yetësi ka pasur disa pyetje lidhur me përdorimin e internetit nga fëmijët, që i referohen të gjitha aktiviteteve online nga çfarëdo pajisje teknologjike. Shkalla në të cilën fëmijët e përdorin dhe si ata i qasen internetit janë faktorë të rëndësishëm që duhet të merren parasysh kur analizohen rreziqet e përdorimit të internetit. Pajisjet që fëmijët i përdorin për t'u kyçur në internet ndikojnë drejtpërdrejtë në aktivitetet online të fëmijëve. Gjithashtu, llojshmëria e aktiviteteve online dhe kohëzgjatja e qëndrimit online mund të përdoren si indikatorë të rëndësishëm nga politikë-bërësit për të zhvilluar politikat në këtë fushë. Duke pasur parasysh ndryshimet e shpejta në metodat e qasjes në internet, hartuesit e politikave duhet të dizajnojnë politika dhe rregullore që të sigurojnë një mjedis të sigurt në internet për fëmijët.

## Sa e përdorin fëmijët internetin?

Siç e kemi parashikuar, shumica e fëmijëve kanë deklaruar që e përdorin internetin më shumë sesa prindërit e tyre. Nga grafikoni i mëposhtëm mund të shihet se 93% e fëmijëve e përdorin internetin, përderisa vetëm 76% e fëmijëve kanë deklaruar që prindërit e tyre e përdorin internetin. Në përgjithësi, nuk kemi hasur në dallime të mëdha në mes të gjinive në përdorimin e internetit.


■ **Figura 1:** Përdorimi i internetit nga fëmijët dhe prindërit



Baza: 1,144

Gjithashtu, respondentët janë pyetur se sa shpesh ata e përdorin internetin. Të gjeturat tregojnë se shumica e fëmijëve e përdorin internetin çdo ditë, një deri në dy orë. Përgjigjet e fëmijëve tregojnë që frekuenca me të cilën fëmijët Kosovar e përdorin internetin është pak a shumë e njëjtë me atë të moshatarëve të tyre Evropian. Grafikonet më poshtë, të bazuara në Pyetësin e Fëmijëve Online të BE-së (EU Kids Online Survey), bëjnë krahasimin mes Kosovës dhe shteteve Evropiane në lidhje me përdorimin e internetit nga fëmijët.


■ **Figura 2:** Sa shpesh e përdorin fëmijët internetin?



Megjithatë, sa i përket orëve të shpenzuara në internet çdo ditë, fëmijët kosovarë përdorin internetin shumë më shumë se moshatarët e tyre evropian. Siç shihet nga Figura 3, shumica e fëmijëve të Kosovës (49%) të cilët e përdorin internetin çdo ditë shpenzojnë më shumë se 2 orë në internet, ndërsa shumica e fëmijëve në vendet e tjera evropiane (60%) shpenzojnë më pak se 1 orë në internet.

Për më tepër, 5% e fëmijëve të moshës 13-16 vjeç dhe 2% e fëmijëve të moshës 9-12 vjeç kanë deklaruar se shpenzojnë çdo ditë më shumë se 4 orë në internet. Studimet e ndryshme tregojnë se ekrani nuk duhet të jetë burimi kryesor i argëtimit për fëmijët. Fëmijët mësojnë dhe zhvillohen përmes aktiviteteve në natyrë, kështu që kur ata kalojnë shumë kohë në internet nuk lëvizin shumë dhe kanë më pak stimulim mendor e fizik. Disa nga problemet kryesore që mund të dalin nga përdorimi i tepërt i internetit tek fëmijët janë mungesa e gjumit të rregullt, agresioni, mbipesha, dhe depresioni.

■ **Figura 3:** Sa gjatë qëndrojnë fëmijët në internet në suaza ditore?






## Mënyra e qasjes në internet

Fëmijët e përdorin internetin në mënyra të ndryshme, nga pajisje të ndryshme elektronike dhe ambiente të ndryshme. Kjo ndryshon mjaft varësisht nga mosha e tyre, interesat dhe rrethanat të tjera të caktuara.

Deri vonë, qasja në internet është bërë nga kompjuteri qoftë në shtëpi apo diku tjetër, por me përhapjen e telefonave të mençur dhe pajisjeve tjera të personalizuar, kanë ndryshuar metodat e përdorimit të internetit. Gjithnjë e më shumë, interneti është duke u përdorur në mënyrë private, dhe kështu është rritur pamundësia e mbikëqyrjes së fëmijëve në internet.

Gjetjet e raportit tregojnë se përdorimi i telefonave mobil për t'u kyçur në internet është rritur ndjeshëm në dy vitet e fundit. Një studim i mëparshëm i vitit 2012, bërë nga Qendra FIT për përdorimin e internetit nga fëmijët tregoi që 43% e fëmijëve e kanë përdorur internetin nga telefonat e tyre, ndërsa tani kjo përqindje është rritur në 60%.


**Figura 4:** Pajisjet nga të cilat fëmijët e përdorin internetin



Për të parë se sa e preferojnë fëmijët privatësinë dhe më saktësisht nga cili ambient qasen në internet, si dhe për të konfirmuar edhe njëherë pyetjen e mësipërme, njëra ndër pyetjet për fëmijët ishte se ku e përdorin më së shpeshti internetin.

Siç tregon Figura 5, më poshtë, shumica e fëmijëve e përdorin internetin në shtëpi. Përdorimi i internetit nga shtëpia është më i rrezikshëm sesa përdorimi i internetit nga vendet publike siç është shkolla. Sipas pyetësorit të kryer me fëmijët e BE-së, fëmijët evropian më së shumti e përdorin internetin nga shkolla (69%), gjë që menjëherë zvogëlon rreziqet pasi që është më lehtë të monitorohet nga mësuesi. Të gjeturat tona tregojnë që vetëm 11% e fëmijëve në Kosovë e përdorin internetin nga shkolla. Duke pasur parasysh që fëmijët kosovar e përdorin internetin me shumë sesa vetë prindërit, është shumë e vështirë për prindërit të kontrollojnë apo monitorojnë përdorimin e internetit nga fëmijët.

■ **Figura 5:** Ku e përdorin fëmijët internetin?




Të dhënat e mësipërme tregojnë që përdorimi i internetit nga fëmijët në Kosovë është tej mase i personalizuar dhe kështu shumë më vështirë kontrollohet nga prindërit apo mësuesit. Sipas shumë studimeve, kjo dukuri është mjaft shqetësuese dhe rekomandohet që kompjuteri në shtëpi të vendoset në dhomën e ndejës dhe pozicionimi i monitorit të bëhet në atë mënyrë që të gjithë të kenë mundësi të shohin monitorin gjatë përdorimit të internetit nga fëmijët. Kjo është një gjetje mjaft e rëndësishme e raportit pasi që informon politikë-bërësit që të fokusojnë politikën dhe strategjitë e tyre rreth identifikimit të mënyrave të trajnimit të mësuesve për njohuri digjitale në mënyrë që ata të transmetojnë këtë njohuri edhe tek fëmijët që të promovojnë mënyra më të mira të përdorimit të internetit.

## Njohuria digjitale dhe masat e sigurisë

Njohuria digjitale, e përcaktuar si aftësi për të shfletuar dhe për të kërkuar informacione në internet duke përdorur në mënyrë efektive lloje të ndryshme të teknologjive digjitale, është ndër faktorët më të rëndësishëm në formësimin e aktiviteteve të fëmijëve në internet. Shumëllojshmëria e aktiviteteve në internet varet direkt nga aftësia e fëmijëve për të kuptuar kompleksitetin e pajisjeve digjitale dhe internetit. Supozohet se sa më shumë njohuri digjitale që fëmijët kanë aq më të përgatitur do të jenë për të shmangur rreziqet online. Kur u pyetën për të treguar nëse ata dinë dhe kuptojnë përdorimin e internetit, 44% e fëmijëve kanë deklaruar të kenë njohuri solide, 42% njohuri mesatare, ndërsa 14% kanë njohuri të kufizuara.


Njohuria digjitale është e lidhur edhe me masat e sigurisë të përdorura për t'u vetëmbrojtur gjatë përdorimit të internetit. Kur u pyetën nëse ata ndihen të sigurt gjatë përdorimit të internetit, fëmijët në Kosovë kanë raportuar si në vijim:

■ **Figura 6:** Sa ndihen të sigurt fëmijët gjatë përdorimit të internetit?



Gjetjet sugjerojnë se fëmijët në Kosovë ndihen disi të sigurt kur përdorin internetin. Edhe pse 35% e fëmijëve kanë deklaruar se ata ndjehen shumë të sigurt, 26% e fëmijëve deklaruan të kundërtën. Është shumë e rëndësishme të kuptohet se sa dinë fëmijët për sigurinë në internet, kështu që ne kemi pyetur fëmijët nëse ata mund të identifikojnë përmbajtjet ilegale në internet, dhe në qoftë se ata u janë ekspozuar ndonjëherë përmbajtjeve të tilla. Dhe rezultuat me përgjigjet e mëposhtme:

■ **Figura 7:** Identifikimi i përmbajtjes ilegale në internet



Siç tregon Figura 7, shumica e fëmijëve (57%) nuk mundën ose nuk janë të sigurt në identifikimin e përmbajtjeve ilegale në internet. Kjo gjithashtu shpjegon përqindjen e ulët të fëmijëve (33%) që kanë deklaruar në hasjen e përmbajtjeve ilegale online. Këto rezultate tregojnë që fëmijët në Kosovë nuk janë plotësisht të vetëdijshëm për rreziqet që vijnë nga interneti. Edhe pse fëmijët pretendojnë të kenë njohuri solide të internetit, përgjigjet e tyre tregojnë se këto

njohuri janë të kufizuara pasi që një numër i konsiderueshëm i fëmijëve raportuan se ata nuk ndihen të sigurt dhe nuk mund të identifikojnë përmbajtje ilegale në internet.

## Përdorimi i (pa)mbikëqyrur i internetit

Ky seksion i raportit fokusohet në mënyrat që fëmijët përdorin për të mësuar rreth masave të sigurisë në internet dhe shkallën në të cilën ata mund të mbikëqyren gjatë qëndrimit në internet. Fëmijët u pyetën nëse ata kanë marrë informacion ose këshilla në lidhje me përdorimin e sigurt të internetit dhe rreth 70% e tyre deklaruan që kanë marrë informata në këtë fushë. Përveç kësaj, ne i kemi pyetur ata për këshillat të cilat mësuesit i kanë dhënë mbi çështjen dhe kemi marrë këto përgjigje:

**Tabela 1:** Ndërmjetësimi i mësuesve në sigurinë e fëmijëve në internet (në përqindje)

Kategoritë	Po	Jo	Nuk e di	Total
Kanë treguar se si të vepronin në internet	54	41	5	100
Kanë ndihmuar kur keni hasur në vështirësi	58	38	6	100
Kanë sqaruar pse disa ueb faqe janë të mira apo të dëmshme	60	33	7	100
Kanë sugjeruar mënyra për të përdorur internetin në mënyre të sigurt	55	37	7	100
Kanë sugjeruar mënyra si të silleni me personat tjerë në internet	47	44	9	100
Kanë sqaruar se çka duhet të bëni nëse hasni në përmbajtje shqetësuese në internet	39	51	10	100

Në përgjithësi masat e sigurisë online mund të ju mësohen fëmijëve në shkollë nga bashkë-moshatarët dhe mësuesit ndërsa në shtëpi nga prindërit ose të afërmit. Tabela e mësipërme tregon që mësuesit kanë një rol shumë të rëndësishëm në edukimin e fëmijëve për sigurinë në internet. Në shumicën e rasteve, fëmijët kanë deklaruar që mësuesit e tyre i informojnë për rreziqet në internet, por, 61% e fëmijëve kanë raportuar që mësuesit e tyre nuk ju kanë treguar për mekanizmat reagues ndaj rreziqeve në internet. Kjo gjetje duhet të tërheq vëmendjen e politikë-bërësve në mënyrë që të trajnojnë mësimmësuesit për mënyrat e reagimit ndaj rreziqeve të tilla.


Fatkeqësisht nuk mund të thuhet që situata me prindërit është kaq optimiste sa ajo me mësuesit. Siç është cekur më lartë, shumica e fëmijëve kosovar e përdorin internetin në shtëpi, prandaj edhe përfshirja e prindërve në edukimin e fëmijëve për rreziqet në internet është më i rëndësishëm se ai i mësuesëve.

Të dhënat tregojnë që prindërit kosovar kanë njohuri më të kufizuara të internetit sesa fëmijët. Edhe pse 76% e fëmijëve kanë deklaruar që prindërit e tyre e përdorin internetin, 70% e fëmijëve kanë deklaruar që kanë më shumë njohuri se prindërit e tyre për të përdorur internetin. Këto statistika tregojnë që është shumë e vështirë për prindërit të monitorojnë apo kontrollojnë aktivitetet e fëmijëve në internet pasi që ata kanë më pak njohuri sesa fëmijët.

Gjithashtu fëmijët janë pyetur nëse prindërit e tyre dinë çfarë aktivitete zhvillojnë fëmijët në

internet, dhe 34% e fëmijëve kanë deklaruar që prindërit kanë pak njohuri për këto aktivitete. Edhe pse pjesa tjetër e fëmijëve kanë pohuar që prindërit i dinë aktivitetet e tyre, prindërit nuk i menaxhojnë apo kontrollojnë këto aktivitete. Kjo më së miri dëshmohet nga rezultatet e pyetjes për aktivitetet të cilat fëmijët janë të lejuar nga prindërit t'i bëjnë në internet.

■ **Figura 8:** Aktivitetet e lejuara për fëmijët nga prindërit në internet



Siç shihet nga figura më lartë, fëmijët Kosovar kanë shumë pak kufizime në aktivitetet e tyre pasi që shumica e këtyre aktiviteteve nuk monitorohen/ndalohen nga prindërit. Në pjesët e mëposhtme të raportit do të elaborohen më shume efektet që monitorimi i dobët i përdorimit të internetit ka tek fëmijët.

# AKTIVITETET E FËMIJËVE NË INTERNET

Përmes pyetësorit tonë jemi përpjekur të kuptojmë se për çfarë e përdorin fëmijët internetin më shumë. Kjo për faktin se duke monitoruar aktivitetin e fëmijëve në internet, prindërit, mësuesit, dhe politikë-bërësit mund të vlerësojnë shkallën e rrezikshmërisë nga qasja në internet. Në këtë aspekt, hulumtimet e ndryshme kanë treguar se fëmijët që përdorin internetin për një kohë të gjatë kanë mundësi që të mësojnë më shumë mirëpo edhe ekspozimi ndaj rrezikut është më i lartë.

## Aktivitetet kryesore

Përdorimi i internetit nga fëmijët dallon dukshëm krahasuar me të rriturit. Hulumtime nga autorë të huaj tregojnë që prindërit zakonisht e përdorin internetin për e-mail dhe kërkime në internet, kurse fëmijët për biseda në mes tyre, kryesisht në rrjete sociale, muzikë, lojëra dhe blogje. Rezultatet e nxjerra nga Qendra FIT tregojnë se rrjetet sociale (Facebook, Twitter, etj.), dëgjimi i muzikës në YouTube dhe video lojërat e ndryshme në internet janë aktivitetet më të shpeshta në internet nga fëmijët e Kosovës.

■ **Tabela 2:** Aktivitetet e preferuara të fëmijëve në internet

	Gjinia		Mosha		Total
	Mashkull	Femër	9 - 12 vjeç	13 - 16 vjeç	
Facebook	79.7	67.9	70.3	80.7	74.2
Music	64.9	77.1	71.3	69.4	70.5
YouTube	59.6	58.1	58.2	59.9	58.9
Lojëra	52.1	38.5	52.7	34.6	45.8
Chat - Messenger	23.4	20.7	17.4	29.7	22.1
Instagram	19.6	25.0	16.6	31.1	22.1
Wikipedia	19.6	19.0	19.1	19.6	19.3
Kërkim në Ueb	16.5	13.4	12.8	18.7	15.0
Nuk e di/Tjetër	4.5	6.0	5.3	5.1	5.2


Nga këto rezultate mund të nxjerrim që fëmijët në Kosovë më së shumti e përdorin internetin për argëtim (p.sh. Muzikë 70.5%) dhe për të komunikuar më njëri tjetrin (p.sh. Facebook 74.2%). Rrjetet sociale përbëjnë një ndër aktivitetet më të preferuara të fëmijëve, përderisa kërkimi në internet për gjëra të ndryshme nuk është shumë i popullarizuar. Është me rëndësi të ceket që përdorimi i internetit për çështje akademike apo profesionale paraqet shumë më pak rrezik për fëmijët sesa përdorimi për komunikim. Për këtë arsye, sa më i madh të jetë përdorimi i internetit për komunikim (Facebook, Twitter, Instagram) ose argëtim (dëgjimi i muzikës apo videot në Youtube), aq më i madh është ekspozimi i fëmijëve ndaj rreziqeve të ndryshme siç janë: sjabërdhuna, takimet me njerëz të rinj, apo keqpërdorimi i të dhënave personale.

## Rrjetet Sociale

Interneti ka ndryshuar shumë jetën e fëmijëve dhe stilin e jetesës. Në ditët e sotme, shumë fëmijë kalojnë orë të tëra në rrjete sociale. Rrjetet më të popullarizuara nga fëmijët jo vetëm në Kosovë por në mbarë botën janë Facebook, Twitter, MySpace, Hi5, LinkedIn, Flickr dhe MSN. Ato janë duke u bërë gjithnjë e më të përsosura sa i përket mundësisë së shkëmbimit të informatave me palët tjera si dhe ofrojnë një mundësi të shkëlqyeshme për komunikim. Këto rrjete po integrohen gjithnjë e më tepër edhe në telefona mobil duke ofruar kështu një mundësi të shkëlqyeshme për të shkëmbyer mesazhe, fotografi, video, informata, adresa, etj. brenda një kohe shumë të shkurtër dhe duke ofruar mundësi të shpërndarjes shumë të shpejtë.

Me gjithë mundësitë e mira që ofrojnë këto rrjete sociale, paraqiten edhe rreziqe të natyrave të ndryshme që tek fëmijët mund të ndikojnë shumë negativisht. Për shembull, shkarkimi i një videoje apo fotografie mund të bartë viruse të fshehura; postimi i fotografive i jep mundësi të tjerëve për të manipuluar me fotografitë e postuara; në rrjete sociale shpeshherë persona të ndryshëm ushtrojnë sajberdhunë; ka të atillë që krijojnë profile apo edhe ueb faqe të rrejshme me qëllim që të shantazhojnë dikë; përdorimi i kamerës gjatë bisedave ju ofron keqbërësve një mundësi për të bindur fëmijët që të takohen me ta. Gjatë këtyre takimeve fëmija mund të lëndohet keq, ngacmohet, dhunohet apo edhe të rrëmbehet. Është e lehtë të gënjetet online dhe fëmijët lehtë mund të bien viktima të keqbërësve, kurse pasojat mund të jenë afatgjata apo fatale. Prandaj, rritja e njohurive të fëmijëve lidhur me rrezikun dhe sigurinë në internet është me rëndësi të madhe.

■ **Figura 9:** Fëmijët që kanë llogari në rrjete sociale në Kosovë dhe Evropë




Të gjeturat tregojnë që numri i fëmijëve në Kosovë që janë aktiv në rrjete sociale është shumë i lartë në krahasim me shtetet e tjera evropiane. 84% e fëmijëve të moshës 9-16 vjeçare në Kosovë kanë raportuar që kanë llogari në Facebook apo Twitter. Në anën tjetër, vetëm 59% e fëmijëve evropian kanë llogari aktive në rrjete sociale. Grafikoni i sipërm bën krahasimin e përqindjeve të fëmijëve që kanë llogari aktive në rrjete sociale në Kosovë dhe Evropë.

Siç shihet nga figura, fëmijët kosovar janë përdoruesit më aktiv të rrjeteve sociale në Evropë. Nëse krahasohemi me shtetet e rajonit sikur Bullgaria (54%), Rumania (46%) apo Turqia (49%), fëmijët Kosovar janë shumë më aktiv sesa moshatarët e tyre.

Rrjetet sociale janë më të popullarizuara në Prizren (91%) dhe Gjilan (89%), dhe më pak të popullarizuara në Gjakovë (76%) dhe Mitrovicë (78%). Gjithashtu të gjeturat tregojnë që djemtë (91%) i përdorin më shumë rrjetet sociale sesa vajzat (76%); ndërsa, nuk shihen dallime të mëdha mes grupmoshave, 9-12 vjeçarët (82%) dhe 13-16 vjeçarët (88%). Kur janë pyetur të tregojnë numrin e shokëve në rrjete sociale, fëmijët kanë raportuar rezultate shqetësuese. Grafikoni i mëposhtëm i përmbledh këto të dhëna sipas grupmoshave:

■ **Figura 10:** Numri i shokëve që i kanë fëmijët në rrjete sociale



Siç tregon shtylla e katërt e grafikonit, numri i fëmijëve me më shumë se 400 shokë rritet me moshën dhe kulmin e ka në moshën 13 vjeç. Trendi i njëjtë është edhe me numrin e fëmijëve me më shumë se 1000 shokë. Facebook-u kërkon që të gjithë përdoruesit të jenë së paku 13 vjeç para se të mund të krijojnë një llogari (në disa juridiksione, limiti i moshës mund të jetë edhe më i lartë). Përveç kësaj, gjetjet sugjerojnë se në përgjithësi djemtë kanë më shumë shokë se sa vajzat. Mund të aludohet që fëmijët e moshës 9-12 vjeçare gënjejnë për moshën e tyre në mënyrë që të krijojnë profile në faqet e internetit që aplikojnë kufizimin e qasjes me moshën e përdoruesit.

Pa diskutim, sa më i lartë të jetë numri i shokëve në rrjete sociale dhe sa më të rinj që ata janë, aq më i lartë është rreziku për keqpërdorim të të dhënave personale, sjabërdhunë, apo rreziqe tjera. Gjithashtu, fëmijët më të rinj kanë më pak njohuri për rregullimin e privatësisë në rrjete sociale prandaj ata janë më të ekspozuar ndaj rreziqeve. Vetëm 9% e fëmijëve në vendet e tjera evropiane kanë deklaruar të kenë më shumë se 300 shokë në profilet e tyre të rrjeteve sociale.


Është jashtëzakonisht e vështirë të bëhet dallimi në mes të aktiviteteve në internet që japin rezultate pozitive dhe atyre që rrisin rrezikun për dëme; megjithatë, të gjeturat e këtij raporti duhet të shërbejnë si paralajmërim për politikë-bërësit që të fillojnë edukimin e fëmijëve dhe mësuesëve për efektet e përdorimit të rrjeteve sociale.



## Video lojërat në internet

Përveç profileve në rrjetet sociale, video lojërat online gjithashtu ofrojnë një platformë shumë atraktive për fëmijët. Për shkak të avancimit të teknologjisë, lojërat online tanimë integrojnë mundësinë për të biseduar mes vete me zë apo video, apo për të shkëmbyer informata personale. Fëmijë nga e gjithë bota mund të luajnë së bashku dhe të komunikojnë mes vete përmes ueb faqeve të lojërave. Shumë lojëra online ofrojnë mundësinë që fëmijët të flasin me njëri tjetrin përderisa luajnë, duke i ekspozuar ata ndaj rreziqeve të ndryshme. Rreziqet më të shpeshta që hasen nga lojërat online janë sabërdhuna, vjedhja apo keqpërdorimi i informatave personale, dhe joshja. Padyshim që lojërat online janë aktivitete shumë të pëlqyeshme edhe për fëmijët kosovar.


■ **Figura 11:** Fëmijët që luajnë lojëra në internet



Video lojërat online paraqesin rreziqe sociale por edhe teknologjike. Sa i përket rreziqeve sociale, përderisa ueb faqet e lojërave kanë mundësi të integrojnë video mesazhe dhe mundësi komunikimi verbal, mashtruesit mund të përdorin këtë mundësi për të marrë informata personale, informata të kredit kartelës, apo të ngacmojnë seksualisht fëmijët. 7% e fëmijëve kanë deklaruar që janë ngacmuar nga persona tjerë përderisa kanë qenë duke luajtur lojëra online. Rreziqet teknologjike përfshijnë infektimin e kompjuterit nga virus të ndryshëm, instalimi i softuerëve të dëmshëm, dhe komprometimi i sigurisë së përgjithshme të kompjuterëve.

Fëmijët janë lutur të identifikojnë se cilat lloje të lojërave ata i preferojnë më shumë, dhe ata raportuan këto rezultate:

■ **Figura 12:** Çfarë lojëra luajnë fëmijët në internet?



Rezultatet tregojnë që 29% e fëmijëve në Kosovë luajnë lojëra me përmbajtje agresive apo luftarake. Hulumtimet kanë treguar se ekspozimi ndaj dhunës në televizion dhe lojërat e dhunshme rrisin sjelljen agresive tek fëmijët. Disa autorë argumentojnë se fëmijët që luajnë video lojëra të dhunshme për periudha të gjata kohore kanë tendencë të jenë më agresiv, janë më të prirur për konflikte me bashkëmohatarët e tyre, mësuesit, ose prindërit, dhe shënojnë rënie në arritjet shkollore.

Dëmet e mundshme nga lojërat në internet mund të minimizohen nëse prindërit e kufizojnë sasinë e kohës që fëmijët luajnë, si dhe kontrollojnë llojet e lojërave që ata luajnë. Mësuesit mund të diskutojnë me fëmijët për dëmet e lojërave të dhunshme dhe se si ato inkurajojnë sjellje agresive në jetën reale.

# RREZIQET

**P**adyshim interneti ka ndryshuar mënyrën se si fëmijët komunikojnë me njëri tjetrin dhe me botën. Tani, më shumë se kurrë, fëmijët kanë njohuri të gjera dhe mjete të llojllojshme për të shprehur kreativitetin e tyre dhe për tu lidhur me njëri tjetrin. Sidoqoftë, duke ofruar mënyra të ndryshme për t'u lidhur dhe bashkëvepruar me botën, interneti po ashtu ofron rreziqe të reja për përdoruesit e tij. Inkurajimi i përdorimit të internetit në mënyrë të përgjegjshme dhe të sigurt si dhe njohja me rreziqe potenciale janë hapa kyç në krijimin e një platforme për menaxhimin e rrezikut që t'i mbajmë fëmijët të sigurt në internet.

Ka shumë ueb faqe që kanë përmbajtje ilegale të cilave fëmijët mund t'iu qasen në çdo kohë. Për të ilustruar këtë, vetëm gjatë vitit 2012, "UK Internet Watch Foundation" ka identifikuar 9550 ueb faqe të cilat kanë pasur përmbajtje të abuzimit seksual të fëmijëve. Kjo statistikë tregon për mundësinë e madhe që fëmijët kanë në qasjen e tyre në ueb faqe me përmbajtje jo adekuate si dhe rrezikun që të ndikohen nga dhuna e tepruar.

Disa rreziqe të adresuara nga pyetëtori jonë, po ashtu edhe nga ky raport, janë: shikimi i videove me përmbajtje jo adekuate online (pornografike, përmbajtje seksuale dhe lojëra agresive), takimi me persona të rinj, keqpërdorimi i të dhënave personale dhe sulmi nga viruset.

## Përmbajtja e papërshtatshme pornografike


Disa ueb faqe përmbajnë materiale ilegale, ndërsa të tjerat mund të jenë legale, por janë të lejuara vetëm për të rriturit. Përmbajtjet pornografike në ueb janë duke u rritur gjithnjë e më shumë dhe nga dita në ditë ky fenomen është duke u bërë edhe më i rëndë. Ky fakt rrit gjasat që fëmijët rastësisht t'i ekspozohen të ashtuquajturve sulme 'spam' në rrjete sociale apo nga viruset e ndryshme. Në përgjithësi, fëmijët mund të kenë qasje në përmbajtjet pornografike rastësisht ose qëllimisht nga kurioziteti.

Për shkaqe etike në pyetësin e zhvilluar nga Qendra FIT, nuk ka pasur mundësi që pyetjet për pornografinë të formulohen në formë eksplicite, në mënyrë që të mos iu tërheqim vëmendjen për një fenomen me të cilin fëmijët mund të mos jenë të njohur. Për këtë arsye, pyetjet në lidhje me përmbajtje seksuale nuk kanë qenë të përfshira në anketën e bërë për fëmijët nën moshën 13 vjeçare. Pyetjet në lidhje me përmbajtjet seksuale për fëmijët 13-16 vjeç kanë qenë të paraqitura në këtë mënyrë:

*"Në 12 muajt e kaluar, ju mund të keni parë pamje të ndryshme në internet – fotografi, video, etj. Shpeshherë, këto pamje kanë përmbajtje të papëlqyeshme (pornografike). Ju ndoshta nuk keni parë diçka të këtyllë, ose keni parë diçka të këtyllë: p.sh. në telefonin mobil, revista, TV, ose DVD apo edhe në Internet."*

Rezultatet mbi rrezikun nga përmbajtjet erotike në internet për fëmijët, janë treguar në grafikun e mëposhtëm:

■ **Figura 13:** Fëmija ka parë imazhe me përmbajtje pornografike gjatë vitit të kaluar




Në aspektin e gjinisë, djemtë (45%) kanë raportuar se kanë shikuar më shumë (si në përqindje ashtu edhe në shpeshësi) përmbajtje pornografike se sa vajzat (31%). Ekspozimi më i madh ndaj videove me përmbajtje pornografike në internet është te fëmijët në Gjiilan (61%), Prizren (48%), Gjakovë (43%), dhe në Ferizaj (33%); ndërsa, ekspozimi më i vogël është në Prishtinë (32%), Pejë (29%) dhe Mitrovicë (25%).

Shikimi i videove me përmbajtje pornografike në internet mund të mos ketë ndikim të njëjtë te secili fëmijë. Varësisht nga fëmija, shikimi i këtyre videove mund të ketë ose të mos ketë ndonjë ndikim, pozitiv apo negativ. Për këtë arsye, i kemi pyetur të gjithë fëmijët që kanë parë video me përmbajtje pornografike, nëse ata janë shqetësuar nga ato pamje. Pyetja ishte formuluar si në vijim:

*“Të shohësh fotografi të papëlqyeshme (pornografike) në internet mund të jetë në rregull ose jo në rregull. Në 12 muajt e fundit, a keni parë ndonjë gjë të këtillë që ju ka shqetësuar juve në ndonjë mënyrë? Për shembull, ju ka bërë të pendoheni, të mërzhitur, apo keni menduar se nuk është dashur t’i shikoni ato.”*


■ **Figura 14:** Fëmija është shqetësuar pasi ka parë pamje seksuale në internet



Siç tregon figura më lartë, 42% e fëmijëve kanë deklaruar se kanë qenë të shqetësuar nga përmbajtjet pornografike. Nga të gjeturat mund të konkludojmë se vajzat janë më pak të prirura të shikojnë video pornografike se sa djemtë (31% kundër 45%), dhe zakonisht janë më të shqetësuar se sa djemtë nga këto video (45% kundër 40%).


Shikimi i videove pornografike padyshim që përcaktohet edhe nga pajisja të cilën fëmijët e përdorin për qasje në internet. Grafikoni në vijim është kombinim i dy variablave dhe tregon përqindjen e fëmijëve që kanë shikuar video pornografike dhe kanë qenë të shqetësuar nga ajo çfarë kanë parë, si dhe pajisjen që e kanë përdorur për të parë video të tilla.

■ **Figura 15:** Pajisjet nga të cilat janë parë përmbajtjet pornografike



Përgjigjet në këtë pyetje kanë dalë mjaft interesante. Shumica e fëmijëve në Kosovë (68%) të cilët kanë raportuar se kanë qenë të mërzitur ose të shqetësuar kur kanë parë video me përmbajtje pornografike online, kanë përdorur telefonat e tyre për të shikuar këto video. Pajisja e dytë më e përdorur është kompjuteri me 66%. Përveç analizimit të pajisjeve që fëmijët përdorin për të shikuar video pornografike, edhe vendi i qasjes në internet është shumë i rëndësishëm për tu analizuar.

■ **Figura 16:** Vendi nga i cili fëmijët shohin video me përmbajtje pornografike



Shumica e fëmijëve (80%) të cilët kanë shikuar përmbajtje pornografike e kanë bërë këtë në shtëpinë e shokut/shoqes. Kjo është e rëndësishme pasi që tregon që fëmijët kanë shikuar përmbajtje jo adekuate përderisa kanë qenë të shoqëruar nga shokët e tyre. Fëmijët po ashtu kanë raportuar se shikojnë video pornografike në shtëpi, në dhomën e ndejës (77%), ose në dhomën e tyre të fjetjes (76%).

Në përgjithësi, siç është thënë në pjesën më lartë, kur fëmijët përdorin internetin në vendet publike apo në kompjuterë të përbashkët siç janë shkollat apo në internet kafetë, është më e vështirë që të kenë qasje në përmbajtje të papërshtatshme. Nga ana tjetër, rreziku është më i lartë kur ata përdorin kompjuterë privat pasi që janë më pak të mbikëqyrur.

Fakti që 28% e fëmijëve kanë raportuar se kanë shikuar video me përmbajtje pornografike në shkolla është shumë shqetësuese. Kjo do të thotë se qasja në internet në shkolla nuk është e mbikëqyrur nga mësuesit dhe nuk ekziston bllokimi i ueb faqeve të rrezikshme apo të papërshtatshme për fëmijët nën moshën 18 vjeçare. Këto të gjetura duhet të shërbejnë si paralajmërim për shkollat dhe politikë-bërësit të cilët duhet t'i trajtojnë mësuesit se si të kufizojnë përdorimin e internetit në shkolla.

Në përgjithësi, përdorimi i internetit nga fëmijët në Kosovë është shumë i personalizuar dhe në këtë mënyrë qasja dhe përdorimi i internetit është shumë vështirë të monitorohet nga mësuesit dhe prindërit. Fakti që fëmijët shikojnë përmbajtje pornografike në shkolla, internet kafe, në shtëpitë e tyre, të shokut, apo të familjarëve të tyre, tregojnë se as prindërit dhe as mësuesit nuk mund ti kufizojnë apo bllokujnë ueb faqet në të cilat fëmijët kanë qasje. Veç kësaj, përdorimi i pajisjeve personale siç janë telefonat mobil, apo kompjuterët dhe laptopët personal, vërteton se fëmijët mund ta bëjnë dallimin ndërmjet përmbajtjeve adekuate dhe jo adekuate, pasi që për të shikuar përmbajtje të papërshtatshme ata përdorin më shumë pajisje personale (të cilat janë më të vështira të monitorohen).


## Takimi me njerëz të rinj

Në përgjithësi, shqetësimi më i madh i publikut në lidhje me sigurinë e fëmijëve në internet fokusohet në rrezikun që fëmijët mund të takojnë dikë online, i cili pastaj mund ti abuzoj në takimin ballë për ballë. Rezultatet nga pyetësi tregojnë se ky shqetësim nuk është krejtësisht i pa bazë pasi që fëmijët në Kosovë takohen vazhdimisht me njerëz të panjohur nga interneti. Siç është shpjeguar më lartë, fëmijët në Kosovë kryesisht përdorin internetin për të komunikuar me të tjerët. Fëmijët kanë raportuar se përdorimi i rrjeteve sociale është aktiviteti më i përhapur online, ku 84% e fëmijëve kanë deklaruar që kanë llogari aktive në Facebook ose Twitter. Gjithashtu, 32% e fëmijëve nën moshën 13 vjeçare, të cilët kanë më pak informata rreth rregullimit të parametrave të privatësisë së profilit, kanë pohuar se kanë më shumë se 400 shokë në rrjetet e tyre sociale.

Rrjetet sociale ofrojnë një platformë të komunikimit e cila shumë lehtë mund të keqpërdoret nga të rriturit dhe mund të nxisë apo ndihmojë keqbërësit që të ngacmojnë fëmijët duke lënë kështu pasoja serioze tek fëmijët. Informacionet e marra nga pyetësi tregojnë se është e zakonshme që fëmijët në Kosovë të postojnë informacione personale (fotografi, emrin e shkollës, adresën elektronike) në rrjetet e tyre sociale, duke i bërë ata të jenë një objekt relativisht i lehtë për keqbërësit në internet.

Duke marrë parasysh rëndësinë e trajtimit të kësaj pyetjeje në këtë raport, në pyetësor kemi përfshirë gjashtë pyetje në mënyrë që të elaborojmë sa më shumë këtë çështje. Pyetësi është fokusuar në njoftimin me njerëz të rinj nga interneti që qon deri në takime ballë për ballë të fëmijëve me këta njerëz të panjohur, dhe pastaj elaboron më tutje nëse këto takime kanë rezultuar shqetësuese për fëmijët.


■ **Figura 17:** Fëmija ka kontaktuar dikë të panjohur në internet, ose është takuar me të panjohur



Të gjeturat tregojnë se 58% e fëmijëve kanë biseduar në internet me dikë që nuk e kanë njohur personalisht më parë dhe, 69% e këtyre fëmijëve janë takuar me të panjohur nga bisedat në internet.

Për të zbuluar më shumë lidhur me eksperiencën e fëmijëve të cilët janë takuar me njerëz të panjohur, fëmijët që janë përgjigjur pozitivisht i kemi pyetur se sa njerëz kanë takuar në këtë mënyrë. Për shkak të interpretimit sa më të saktë të kësaj statistike, është e rëndësishme të shpjegohet se kjo pyetje përfshinë vetëm fëmijët që kanë raportuar që janë takuar me njerëz të panjohur nga interneti, që përbën vetëm 44% e të gjithë fëmijëve të cilët përdorin internetin.

■ **Figura 18:** Numri i njerëzve të panjohur që fëmijët i kanë takuar ballë për ballë




Siç tregon figura, 44% e fëmijëve që janë takuar me dikë që kanë njohur vetëm përmes internetit, kanë deklaruar se kanë takuar vetëm një ose dy njerëz, 20% kanë takuar tre apo katër njerëz, 11% kanë takuar pesë deri në gjashtë njerëz, dhe 16% kanë takuar më shumë se dhjetë njerëz.

Megjithëse përqindja e atyre të cilët janë takuar me më shumë se dhjetë njerëz të panjohur nga interneti nuk është shumë e lartë, prapë se prapë paraqet një statistikë alarmuese. Kjo tregon se, 81 fëmijë (16%) takohen me më shumë se dhjetë njerëz të panjohur në vit. Kur krahasohet me pjesën tjetër të Evropës, ku 77% e fëmijëve kanë deklaruar se takohen me më pak se katër njerëz në vit, del që fëmijët Kosovar janë më shumë të rrezikuar nga takimet me njerëz të panjohur në internet.

Përveç analizimit të numrit të njerëzve që ata takojnë, është e rëndësishme të kuptojmë dhe vlerësojmë se si fëmijët e perceptojnë rrezikun kur takohen me njerëz të panjohur nga interneti. Takimi me njerëz të panjohur mund të mos jetë fare i dëmshëm dhe të rrisë rrethin e miqve të fëmijëve, por takimet e tilla mund të rezultojnë edhe shumë të rrezikshme pasi që fëmijët mund të takohen me kriminel apo keqbërës të ndryshëm. Ne kemi pyetur fëmijët për dëmin subjektiv si në vijim:

*“Takimi me dikë personalisht të cilin për herë të parë e keni njoftuar përmes internetit mund të jetë në rregull apo jo në rregull. Në 12 MUAJT e fundit a keni takuar dikë, në këtë mënyrë, i cili ju ka shqetësuar juve (p.sh. penguar, nervozuar, mërzitur, lënduar)?”*

■ **Figura 19:** Fëmija ka qenë i shqetësuar pas takimit me person të panjohur



Nga të gjithë fëmijët të cilët janë takuar me persona të panjohur në internet, 48% e tyre kanë deklaruar se kanë qenë të shqetësuar nga këto takime. Siç është pritur, moshë më e re (9-12 vjeç) janë shqetësuar më shumë nga takimet me të panjohurit. Mirëpo, në kundërshtim me frikën e shoqërisë që vajzat janë më të rrezikuara nga këto takime, vajzat kanë raportuar eksperiencë më pak negative se sa djemtë. Figura në vijim përmbledh rezultatet mbi numrin e personave të panjohur të cilët fëmijët i kanë takuar dhe janë shqetësuar nga këto takime.



■ **Figura 20:** Numri i personave të panjohur që fëmijët kanë takuar dhe janë shqetësuar nga ky takim





Figura tregon se shumica e fëmijëve (50%) takohen me një deri në dy të panjohur. 19% e fëmijëve të cilët janë takuar me të panjohur dhe kanë qenë të shqetësuar nga këto takime kanë deklaruar se kanë takuar në këtë mënyrë më shumë se dhjetë persona në vitin e fundit. Takimi i shpeshtë me të panjohurit nga rrjetet sociale paraqet rrezik serioz për fëmijët dhe mund të shpie deri te ofendimi, ngacmimi, shqetësimi, madje edhe tek dhunimi i tyre. Kur besimi i fëmijës veç është fituar nga i rrituri apo keqbërësi dhe takimi është caktuar, fëmija është në rrezik të madh nga dëmi fizik dhe psikologjik. Profilet e rrejshme mund të krijohen shumë lehtë dhe keqbërësit mund të gënjëjnë për moshën e tyre në mënyrë që ti mashtrojnë fëmijët për t'u takuar me ta.

Por me kënd takohen fëmijët Kosovar? Fëmijët kanë raportuar se më shpesh takohen me djem/meshkuj (61%) sesa me vajza/femra (39%). Figura në vijim tregon moshën e personave me të cilët fëmijët janë takuar dhe janë shqetësuar nga ky takim:

■ **Figura 21:** Moshja e personave të panjohur që fëmijët kanë takuar dhe janë shqetësuar nga ky takim



Nga ata të cilët kanë takuar njerëz të panjohur dhe kanë qenë të shqetësuar nga këto takime, 74% janë takuar me dikë të moshës së tyre, duke sugjeruar se shumica e takimeve bëhen me bashkëmoshatarë. Rreziku i dëmit nga takimi me bashkëmoshatar është më i ulët se sa nga takimi me njerëz më të moshuar. Të gjeturat nga pyetësi dëshmojnë se 10% e fëmijëve që kanë qenë të shqetësuar nga takimi me njerëz të panjohur takohen me njerëz më të vjetër, dhe 4% e tyre takohen me njerëz më të vjetër se 20 vjeç. Mundësia e rrezikut të dëmit fizik dhe psikologjik është më e madhe për fëmijët të cilët takohen me fëmijët të cilët janë më të mëdhenj se ata, madje edhe më e madhe kur takohen me të rriturit.

Pasojat që takimet me të panjohur mund të kenë tek fëmijët duhet të ekzaminohen me kujdes nga shoqëria dhe nevojiten politika reaktive dhe pro-aktive për të adresuar këtë çështje problematike. Ndonëse vetëm 10%, apo 29 fëmijë, kanë raportuar se janë takuar me të panjohur të cilët kanë qenë më të mëdhenj se ata, rreziku i abuzimit fizik dhe psikologjik mbetet i lartë dhe duhet të ketë vëmendjen e nevojshme nga politikë-bërësit, prindërit, dhe mësuesit.

## Rreziqet tjera

Në pjesët më lartë kemi sqaruar disa rreziqe në lidhje me përdorimin e internetit, si: shikimi i videove me përmbajtje pornografike, video lojërat, dhe takimet me njerëz të rinj. Këto rreziqe përmenden pothuajse në të gjitha raportet botërore lidhur me sigurinë në internet. Ka rreziqe të tjera të cilat kanë nevojë për vëmendjen e politikë-bërësve, por për arsye financiare dhe të kufizimit kohor nuk ishte e mundur të elaborohen në këtë raport në detaje sikur rreziqet tjera.

### Publikimi i të dhënave personale


Ka shumë faktorë që mund të ndikojnë në ekspozimin e fëmijëve ndaj rreziqeve të ndryshme në internet, dhe njëri nga këta faktorë është edhe shpallja e aktiviteteve të fëmijëve apo mos kontrollimi i parametrave të privatësisë nëpër rrjete sociale apo adresa elektronike. A mund të thuhet që numri i madh i shokëve të fëmijëve nëpër rrjete sociale nënkupton që fëmijët Kosovar nuk i kufizojnë informatat personale në profilet e tyre dhe përfshijnë njerëz të panjohur në listën e shokëve të tyre?

Të dhënat tregojnë që është shumë e zakonshme për fëmijët në Kosovë të publikojnë të dhëna personale (fotografi, emrin e shkollës, adresën elektronike) në profilet e tyre në rrjetet sociale. Çështjet e privatësisë janë elaboruar më tutje dhe fëmijët janë pyetur nëse postojnë fotografi, numrin e telefonit apo adresën e tyre në rrjete sociale.

Rezultatet nga Figura 22 tregojnë se shumica e fëmijëve postojnë fotografitë e tyre personale (92%) dhe emrin e shkollës (67%) në rrjetet sociale. Statistikë më shqetësuese është përqindja e fëmijëve (12%) që postojnë numrat e telefonit në profilet e tyre. Publikimi i numrit të telefonit në rrjetet sociale paraqet një rrezik të madh për fëmijët pasi që lehtëson kontaktin personal me të panjohurit.

Në përgjithësi, djemtë publikojnë më shumë informacione personale në internet sesa vajzat. Djemtë kanë një tendencë më të madhe (17%) për të publikuar numrat e tyre të telefonit krahasuar me vajzat (6%). Gjithashtu, 39% e djemve në krahasim me 25% të vajzave postojnë adresën elektronike në profilet e tyre në rrjete sociale.

■ **Figura 22:** Të dhënat personale të cilat fëmijët i postojnë në internet



Fëmijët në Kosovë janë përdorues shumë aktiv të rrjeteve sociale, prandaj edhe ekspozimi ndaj rreziqeve të ndryshme në internet është i madh. Gjithashtu, duke marrë parasysh numrin e madh të shokëve që kanë në rrjete sociale, postimin e të dhënave personale dhe mungesën e kufizimeve në rregullimin e privatësisë nëpër profile, ky rrezik sa shkon e rritet. Postimet e fëmijëve automatikisht shihen nga qindra apo mijëra njerëz të tjerë të cilët mund ti kontaktojnë ata apo ti keqpërdorin të dhënat e tyre personale.

### Keqpërdorimi i të dhënave personale

Viruset, keqpërdorimi i të dhënave personale, vjedhja e adresës elektronike, postimi i materialeve të pakëndshme, ngacmimi, janë ndër rreziqet e tjera me të cilët fëmijët mund të përballen gjatë kohës që janë në internet. Ne i kemi pyetur fëmijët të tregojnë se a ju ka ndodhur ndonjë prej këtyre gjërave: kompjuteri i tyre është sulmuar nga viruset, të dhënat personale janë keqpërdorur, i është vjedhur e-mail, dikush ka postuar përmbajtje të pakëndshme në muret e tyre, kanë qenë të ofenduar, ngacmuar, ose kërcënuar. Tabela më poshtë përmbledh përgjigjet e tyre:

■ **Tabela 3:** Fëmijët që kanë hasur në keqpërdorim të të dhënave personale në vitin e fundit (në përqindje)

	Po	Jo	Nuk e di	Total
Kompjuteri im është sulmuar nga ndonjë virus	55.1	37.0	7.9	100
Më janë keqpërdorur të dhënat personale	14.6	79.5	5.9	100
Më ka vjedhur dikush e-mailin	19.1	77.5	3.5	100
Dikush më ka postuar përmbajtje të pa këndshme në murin tim	14.6	78.7	6.6	100
Më ka ofenduar, apo etiketuar me ndonjë emër të papëlqyeshëm	19.5	76.4	4.1	100
Më ka bërë të ndihemi i rrezikuar dhe i kërcënuar	12.1	83.3	4.6	100

Rezultatet tregojnë se më shumë se gjysma e fëmijëve (55%), kanë deklaruar se kompjuteri i tyre është sulmuar nga viruset. Viruset në kompjuterë janë programe softuerike të dizajnuar që qëllimisht të ndërhyjnë në operacionet kompjuterike, të korruptojnë të dhënat, ti fshijnë të dhënat, apo të shpërndahen në kompjuterë tjerë përmes internetit. Rrjedhimisht, viruset ndikojnë në sigurinë dhe privatësinë e fëmijëve në internet.

Fëmijët (15%) kanë raportuar që të dhënat e tyre janë keqpërdorur; 17% e të cilëve kanë qenë djem dhe 12% vajza. Gjithashtu rreth 19% e fëmijëve kanë deklaruar se dikush ia ka vjedhur fjalëkalimin e e-mailit personal, ndërsa 15% deklaruan se dikush iu ka postuar përmbajtje të papëlqyeshme në murin e tyre në rrjetet sociale. Veç kësaj, 20% e fëmijëve, prej tyre 25% djem dhe 14% vajza, kanë pohuar se dikush i ka ofenduar ata përmes internetit.

Edhe pse përqindja e fëmijëve që kanë raportuar se kanë qenë të kërcënuar përmes internetit ose që janë ndier në rrezik gjatë vitit të fundit duket të jetë e ulët (vetëm 12% e fëmijëve), kjo ende do të thotë që çdo vit, 131 fëmijë shqetësohen përmes internetit. Ne gjithashtu i kemi pyetur fëmijët nëse ata ndihen të frikësuar dhe 12% e tyre kanë deklaruar se frikësohen lehtë dhe shpeshherë ndihen të frikësuar. Teknologjia dhe interneti i kanë dhënë fëmijëve një platformë krejtësisht të re komunikimi dhe si rrjedhojë ka rritur nivelin e ekspozimit të tyre kundrejt mesazheve dhe teksteve kërcënuese që kanë ndikim negativ tek shëndeti i tyre.

# SAJBËRDHUNA

Sajbërdhuna është përdorimi i pajisjeve elektronike për të ngacmuar, frikësuar, turpëruar, dhe kërcënuar të tjerët nëpërmjet mesazheve, fotografive, dhe postimeve tjera në internet. Sipas përkufizimeve ligjore të SHBA-ve, sajbërdhuna përfshinë postimin e thashethemeve në internet për të tjerët duke mbjellë urrejtje; ose mund të shkoj në atë nivel ku personat që ushtrojnë sajbërdhunë mund të identifikojnë viktimat e tyre dhe të postojnë materiale shumë të ashpra për t'i turpëruar apo diskredituar ata. Me rritjen e përdorimit të teknologjisë, sajbërdhuna është duke u bërë gjithnjë e më e zakonshme, posaçërisht për fëmijët dhe tinejgjerët. Sajbërdhuna është prezente në të gjitha grupmoshat, mirëpo fëmijët ndikohen më lehtë sepse e kanë më të vështirë të përballen me format e sajbërdhunës dhe si pasojë mund të bëhen viktimatë depresionit, frikës, dhe izolimit.

Ka shumë arsye që sajbërdhuna mund të jetë edhe më e rrezikshme se sa dhuna fizike. Personat që ushtrojnë sajbërdhunë mund të jenë persona të cilët viktimat i njeh apo nuk i njeh e që mund të mbesin anonim duke i përdorur email-at e tyre, pseudonimet në chat, mesazhet nga telefonat mobil dhe platformat e tjera të komunikimit përmes internetit për të fshehur identitetin e tyre. Ushtruesit e sajbërdhunës, për shkak se në shumicën e rasteve mbesin anonim, nuk ndjehen të rrezikuar dhe si rezultat bëhen edhe më të rrezikshëm. Mungesa e mbikëqyrjes së forumeve elektronike nga autoritetet shtetërore, prindërit, ose mësuesit, iu mundëson ngacmuesve t'i kenë në shënjestër dhe t'i kontaktojnë viktimat e tyre më lehtë dhe më shpesh. Nëpërmjet rrjeteve sociale, mesazhet dhe fotografitë ofenduese mund të shpërndahen shumë shpejtë tek një audiencë e madhe dhe, është shumë vështirë për autoritetet që të gjejnë personin që i ka shpërndarë ato. Po ashtu, fshirja e këtyre mesazheve bëhet edhe më e vështirë pasi që ato janë postuar dhe dërguar te shumë njerëz.


## Identifikimi i sajbërdhunës

Egzistojnë shumë terme që përdoren për ta përshkruar sajbërdhunën në shqip. Fjalët si ngacmimi, keqtrajtimi, ofendimi, dhe zemërimi shpesh janë të përdorura për të ju referuar dhunës në internet. Sajbërdhuna është një term i vështirë për ta mbajtur në mend apo për ta kuptuar fëmijët, kështu që në pyetësor ne kemi përdorur një tjetër term për ti ndihmuar fëmijëve që t'i kuptojnë më lehtë pyetjet. Deklarata shpjeguese në vijim për domethënien e fjalës Sajbërdhunë është vendosur sipër çdo pyetje:

*“Shpeshherë fëmijët ose adoleshentët thonë ose bëjnë gjëra të dëmshme ose të pakëndshme ndaj dikujt tjetër. Kur njerëzit veprojnë kështu me dikë, këtë mund ta bëjnë në disa mënyra: ballë për ballë (personalisht), përmes telefonit mobil (mesazheve, thirrjeve, videove) apo përmes internetit (e-mailave, mesazheve elektronike, rrjeteve sociale, chate-ve).”*

Pas sqarimeve dhe udhëzimeve që iu janë dhënë fëmijëve për pyetjet lidhur me sajbërdhunën, ata janë pyetur nëse dikush ka ushtruar sajbërdhunë ndaj tyre në 12 muajt e fundit.

■ **Figura 23:** Ngacnimet e fëmijëve përmes internetit ose ndonjë mënyre tjetër në vitin e fundit



Siç shihet nga figura, 28% të fëmijëve kanë përjetuar sjambërdhunë në 12 muajt e fundit. Kur i analizojmë përgjigjet për secilën grup moshë, 9-12 vjeç (33%) dhe 13-16 vjeç (21%), të dhënat tregojnë se fëmijët më të vegjël janë më shumë të ekspozuar ndaj sjambërdhunës. Po ashtu, djemtë (34%) përjetojnë më shumë sjambërdhunë se sa vajzat (22%). Fëmijët po ashtu janë pyetur se sa shpesh janë përballë me dhunën dhe këto statistika janë raportuar.

■ **Tabela 4:** Sa shpesh është ngacmuar fëmija në vitin e fundit?

	Gjinia		Moshë		Total
	Mashkull	Femër	9 - 12 vjeç	13 - 16 vjeç	
Çdo ditë ose pothuajse çdo ditë	12.4	9.5	13.7	7.0	12
Një ose dy herë në javë	14.8	13.8	12.3	19.0	14
Një ose dy herë në muaj	15.2	9.5	14.5	10.0	13
Më rrallë	41.4	47.4	45.8	38.0	43
Nuk e di	16.2	19.8	13.7	26.0	17

Se sa shpesh fëmijët janë përballur me sjambërdhunën, ndryshon nga moshë dhe gjinia. Në total, 12% e fëmijëve kanë pohuar se kanë përjetuar sjambërdhunë çdo ditë, ndërsa 14% kanë pohuar të njëjtën për një ose dy herë në javë. Nga rezultatet e mësipërme mund të themi që fëmijët nën moshën 13 vjeçare (14%) ngacmohen më shumë në internet sesa fëmijët mbi këtë moshë (7%).

Të dhënat tregojnë që 38% e fëmijëve në Kosovë (nga 28% e atyre që kanë pohuar se kanë përjetuar sjambërdhunë) ngacmohen të paktën një herë në muaj. Kjo nënkupton që çdo vit, 128 fëmijë në Kosovë përjetojnë sjambërdhunë së paku një herë në muaj. Disa raporte kanë treguar se për fëmijët të cilët e përjetojnë sjambërdhunën shpesh është më e mundshme që ta braktisin shkollën, të kenë nota më të dobëta, më shumë probleme me shëndet dhe më pak vetëbesim.

## Format e sajërdhunës

Për t'i dhënë kontekst sajërdhunës në lidhje me format e tjera të dhunës, 28% e fëmijëve të cilët kanë deklaruar se kanë përjetuar dhunën psikologjike, janë pyetur që të tregojnë se si ju ka ndodhur një gjë e tillë. Forma më e zakonshme e dhunës psikologjike është raportuar të jetë ballë për ballë: 37% kanë deklaruar se dikush personalisht ka vepruar në mënyrë lënduese ndaj tyre, ndërsa 22% që kanë pohuar që kjo ka ndodhur në forma të tjera. Në mënyrë që të gjejmë se nëse komunikimet online si: adresat elektronike, rrjetet sociale, etj. japin një kontekst për ushtrimin e dhunës psikologjike, ne kemi pyetur fëmijët të tregojnë se në çfarë mënyre kanë qenë të ngacmuar në internet.

■ **Tabela 5:** Mënyrat se si janë ngacmuar fëmijët përmes internetit

	Frekuenca	Përqindje
Përmes rrjeteve sociale	118	53.2
Përmes mesazheve në internet	77	34.8
Chat – Messenger	59	26.7
Me e-mail	35	15.8
Në ueb-faqe të lojërave	19	8.6
Thirrje në telefon, me mesazhe apo video	20	9.1
Tjetër	23	10.5
Nuk e di	32	14.5
	<b>383</b>	-


Edhe pse shumica e fëmijëve nuk kanë qenë të ngacmuar në internet; nga ata që kanë qenë të ngacmuar në internet shumica janë ngacmuar nëpërmjet rrjeteve sociale (53%) ose nga mesazhet online (35%). Ueb faqet e lojërave, thirrjet, mesazhet, ose videot duken platforma më pak të popullarizuara nga ushtruesit e sajërdhunës. Duke pasur parasysh popullaritetin e rrjeteve sociale dhe mundësinë që ato ofrojnë për të integruar fotografi, të dhëna personale, dhe mesazhe është e natyrshme që rrjetet sociale të përdoren më shumë nga ushtruesit e sajërdhunës.

Siç shihet më lartë, shumica e fëmijëve në Kosovë e përdorin internetin për të komunikuar me njëri tjetrin përmes rrjeteve sociale. Rrjetet sociale, siç është Facebook-u, kanë krijuar një platformë të lehtë dhe të favorshme për ngacmuesit të cilët mund të etiketojnë dikë në ndonjë fotografi fyese apo të turpshme, postojnë mesazhe në muret e tyre, dërgojnë mesazhe private kërcënuese, krijojnë faqe publike për viktimat, ose postojnë komente ofenduese në fotografitë ose postimet e tyre.

## Përballja me sjambërdhunën

Përveç analizimit të formave prezente të Sjambërdhunës në Kosovë, ne kemi munduar të kuptojmë edhe mekanizmat që fëmijët përdorin për tu përballur me sjambërdhunën. Se sa shpejt fëmijët i kalojnë përvojat e këqija nga ngacmimet përmes internetit varet edhe nga efikasiteti i teknikave për përballimin e këtyre përvojave. Për të parë se në çfarë mënyre janë përballur fëmijët me problemin në raste të tilla, ne i kemi lutur ata të tregojnë sa të shqetësuar kanë qenë dhe si kanë reaguar ndaj kësaj eksperience (çfarë kanë bërë fëmijët rreth kësaj).

■ **Figura 24:** Fëmija ka qenë i shqetësuar nga ngacmimi në internet



Edhe pse janë të paktë ata fëmijë që ngacmohen online, kur kjo ndodh, është një eksperiencë e hidhur për shumicën prej tyre. Siç shihet nga figura, 67% e fëmijëve të cilët janë ngacmuar online kanë qenë të shqetësuar. Të dhënat tregojnë se vajzat (74%) dhe fëmijët më të moshuar se 13 vjeç (75%) janë më të shqetësuar ose ndjehen më keq nga ngacmimet online sesa djemtë (64%) dhe fëmijët më të rinj se 13 vjeç (63%). Sidoqoftë, politikë-bërësit duhet të fokusohen tek fëmijët të cilët nuk janë aspak të shqetësuar, sepse kjo tregon se 83 fëmijë (20%) nuk janë të vetëdijshëm për rreziqet e sjambërdhunës dhe efektin që ushtrimi i dhunës psikologjike mund ta ketë në shëndetin e tyre.

Megjithatë, si i përgjigjen sjambërdhunës fëmijët në Kosovë? Tabela më poshtë shpalos disa nga mekanizmat që fëmijët i përdorin për tu mbrojtur kur ngacmohen në internet.



■ **Tabela 6:** Çfarë ka bërë fëmija pasi ka qenë i ngacmuar përmes internetit


	Frekuenca	Përqindja
Kam ndalur përdorimin e internetit për një kohë	88	28.2
Kam fshirë çdo mesazh nga personi në fjalë	152	48.6
Kam ndryshuar parametrat e privatësisë	48	15.3
E kam bllokuar personin që të më kontaktoj	176	56.2
E kam raportuar problemin	45	14.4
Asnjërin nga këto gjëra	46	14.7
Nuk e di	34	11.0
	<b>589</b>	-

Nga përgjigjet e marra, mund të kuptojmë se fëmijët në Kosovë më së shumti i përgjigjen sa-  
jberdhunës duke e bllokuar ngacmuesin (56%) ose duke i fshirë mesazhet e marruara nga ngac-  
muesi (49%). Kjo domethënë se përgjigja më e zakonshme ndaj ngacmimit online nga fëmijët  
është fataliste - fëmija provon ta rregulloj problemin vetë. Është e rëndësishme ta përmendim se  
vetëm 15% e fëmijëve kanë pohuar se e kanë ndërruar privatësinë e profilit në rrjetet sociale dhe  
vetëm 14% e kanë raportuar problemin tek të tjerët. Kjo do të thotë që në përgjithësi, fëmijët  
kanë aftësi të limituara të merren me sajbërdhunën pasi që iu përgjigjen vetëm ushtruesit të  
dhunës apo ngacmuesit. Por ka raste që mesazhi ofendues ose poshtërues veç është shpërndarë  
në internet dhe edhe nëse fëmija e bllokoi ngacmuesin, ose prejardhjen e mesazhit, jo domos-  
doshmërisht do të ndal ose fshij mesazhin.

Mbështetja në shoqërinë është njëra ndër format që fëmijët përdorin për tu përballur me sa-  
jberdhunën. 61% e fëmijëve kanë pohuar që kanë biseduar me dikë kur janë ngacmuar në  
internet. Në përgjithësi, vajzat (66%) raportojnë problemin më shumë se djemtë (58%) edhe  
pse djemtë janë të ngacmuar më shpesh se vajzat. Kjo po ashtu mbështet gjetjen e mëparshme  
që vajzat brengosen më shumë nga ngacmimet se sa djemtë.

Tabela 5 tregon qartë se fëmijët në Kosovë hezitojnë t'i raportojnë problemet me të cilat ata  
përballen në internet. Sa për sqarim, fëmijët janë të gatshëm që ta diskutojnë problemin por  
hezitojnë që ta raportojnë atë. Si shpjegim i mundshëm për këtë është mungesa e njohurisë së  
fëmijëve lidhur me mjetet apo mekanizmat shtetërore që ata mund të përdorin për tu mbrojtur  
nga ngacmimet e tilla. Prandaj, këto mund të konsiderohen si të gjetura të rëndësishme për  
politikë-bërësit të cilët duhet të gjejnë mënyra për të rritur vetëdijen e fëmijëve për mjetet dhe  
instrumentet që mund t'i përdorin për tu mbrojtur nga sajbërdhuna (të kontaktojnë policinë,  
apo të konsultojnë ligjet në fuqi).

■ **Figura 25:** Me kënd ka biseduar fëmija pasi ka qenë i ngacmuar në internet?




Ata fëmijë të cilët bisedojnë me dikë preferojnë të bisedojnë me prindërit e tyre (55%), shokët (52%), dhe vëllezërit apo motrat (44%). Vetëm 8% të fëmijëve kanë deklaruar se kanë diskutuar problemet me mësimdhënësit e tyre, e cila nënkupton se çështjet e sigurisë në internet nuk janë të diskutuara në klasë. Mësimdhënësit duhet krijojnë një ambient të relaksuar në klasë ku fëmijët mund të diskutojnë haptazi shqetësimet e tyre në internet, si dhe të marrin këshilla se si t'i shmangin këto situata.

## Efektet e sajberdhunës

Pa dyshim, sajberdhuna ka ndikim shumë negativ tek viktimat e saj. Reagimet që fëmijët i shfaqin ndaj dhunës në internet janë shumë të ngjashme me reagimet ndaj llojeve të tjera të dhunës. Mirëpo, studimet kanë treguar që për shkak se sajberdhuna përfshin ngacmim në publik apo ofendimin e fëmijëve para një audience më të madhe, kjo mund të shkaktojë pasoja më të rënda tek fëmijët. Reagimet më të shpeshta nga fëmijët që janë prekur nga sajberdhuna janë zemërimi, frika, hidhërimi, shqetësimi, dhe të ndjenit i/e lënduar. Veç kësaj, ngacmimet e tilla në internet mund të ndikojnë që fëmijët të kenë koncentrim më të dobët, arritje të ulët në shkollë, dhe të zhvillojnë sjellje anti-shoqërore.

Për të ilustruar se sa përmbajtjet fyese, urryese, apo lënduese në internet mund të ndikojnë tek fëmija, ne kemi pyetur fëmijët të tregojnë se a shpenzojnë shumë kohë duke biseduar me shokët e tyre për atë se çfarë ndodh në internet apo në rrjetet sociale.

■ **Figura 26:** Reagimi i fëmijëve nga përmbajtja në internet



Gjithashtu, për t'i kuptuar disa karakteristika sociologjike dhe psikologjike të fëmijëve, ne po ashtu i kemi pyetur të tregojnë se sa të vërteta janë për ta deklaratat në vijim.

■ **Tabela 7:** Karakteristikat shoqërore dhe psikologjike të fëmijëve

	Jo e vërtetë	E vërtetë	Shumë e vërtetë	Totali
Kam se paku një shok të mirë	22	16	62	100
Shpesh jam i/e mërziur, trishtuar ose i/e përlotur	48	39	13	100
Moshatarëve të mi në përgjithësi ju pëlqej	19	31	49	100
Shpesh me akuzojnë për gënjeshtër ose mashtrim	69	20	10	100
Moshatarët e mi shpesh më trajtojnë sikur të mos isha aty	72	20	8	100
Kaloj më mirë me të rritur sesa me moshatarët e mi	58	27	16	100
Kam frikë nga gjëra të shumta, frikohem lehtë	60	28	12	100

Kemi marrë të dhëna interesante nga këto pyetje, ku 22% e fëmijëve kanë deklaruar se nuk kanë asnjë shok, 52% nganjëherë ndihen të trishtuar dhe të mërziur, 19% kanë deklaruar se shoqëria e tyre nuk e pëlqejnë atë, përderisa 40% kanë raportuar se ata nganjëherë ndjehen të frikësuar.

Nuk mund të spekulohet për arsyet që qëndrojnë mbrapa përgjigjeve që fëmijët kanë dhënë në këto pyetje, pasi që mund të shkaktohen nga shumë faktorë të cilët nuk janë të lidhur me sjambërdhunën. Mirëpo, ne kemi vendosur që t'i përfshijmë këto pyetje në mënyrë që t'i informojmë politikë-bërësit, prindërit, dhe mësuesit se si fëmijët ndjehen shumicën e kohës.

# REKOMANDIME

**S**i pjesë e hartimit të këtij raporti, qendra FIT në bashkëpunim me “Save the Children” kanë organizuar një debat në maj të vitit 2014 ku janë prezantuar të gjeturat nga pyetësi dhe janë ftuar akterë relevant të fushës për të dhënë rekomandimet e tyre për temën. Përfaqësues të Ministrisë së Edukimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Agjencisë për mbrojtjen e të dhënave personale, industrisë së telekomunikacionit, drejtoritë e arsimit nga komuna të ndryshme, drejtorët e shkollave, mësuesit, dhe fëmijët e shkollave pjesëmarrëse në studim ishin prezent në debat dhe kanë dhënë kontributin e tyre në rekomandimet vijuese. Duke u bazuar në rezultatet e nxjerra nga hulumtimi dhe debatet, ne rekomandojmë që zhvillimi i politikave në këtë fushë duhet të përfshijë të gjithë akterët relevant të cilët janë të përfshirë në politikë bërje apo në zbatimin e këtyre politikave. Ne kemi dhënë rekomandime për fëmijët, prindërit, mësuesit, industrinë dhe politikë-bërësit.

Një gjetje e rëndësishme nga studimi është mungesa e inkuadrimin të prindërve që t’i kontrollojnë dhe përkrahin fëmijët e tyre në internet. Shumica e fëmijëve kanë deklaruar se janë më kompetent sesa prindërit e tyre për përdorim të internetit, prandaj vetëdijesimi i prindërve për përdorimin e internetit duhet të rritet. Po ashtu, të dhënat tregojnë se shumica e fëmijëve përdorin internetin në shtëpi, prandaj kanë nevojë për përkrahjen e plotë nga prindërit e tyre për sigurinë në internet. Politikë-bërësit duhet të rrisin vetëdijesimin e prindërve ndaj rreziqeve që fëmijët mund të hasin gjatë përdorimit të internetit. Rritja e njohurive të përgjithshme rreth përdorimit të internetit, mënyrat se si t’i bllokojnë ueb faqet e dëmshme dhe kontrollimi për rreziqe të tjera të mundshme duhet të jenë shtyllat kryesore për fushatat e ngritjes së vetëdijes tek prindërit.

Në përgjithësi, fëmijët në Kosovë fillojnë ta përdorin internetin në moshë shumë të re. Rezultatet tregojnë se vetëm 10% e fëmijëve 9 vjeç nuk kanë qasje në internet. Njohuritë digjitale tek fëmijët e kësaj moshe janë shumë të ulëta ngaqë ata nuk kanë njohuri të mjaftueshme për përdorimin e internetit. Prandaj, duhet të zhvillohen politika që ngritin vetëdijen e fëmijëve të moshave më të reja. Në këtë drejtim, shkollat fillore dhe mësuesit e fëmijëve të klasave 1 deri 5 duhet të marrin informacione në lidhje me sigurinë në internet të cilat pastaj mund t’i transferojnë tek fëmijët.

Gjithnjë e më shumë fëmijët janë duke e përdorur internetin pa mbikëqyrjen e të rriturve. Përderisa shumica e fëmijëve kanë raportuar se e përdorin internetin privatisht, në dhomat e tyre apo nga pajisjet telefonike, është bërë edhe më e vështirë për prindërit që t’i monitorojnë aktivitetet e fëmijëve në internet. Për këtë arsye, politikë-bërësit duhet të bëjnë përpjekje që të zhvillojnë mekanizma të vetë-mbrojtjes dhe vetë-përgjegjësive për fëmijët. Është shumë e rëndësishme t’i edukojmë fëmijët që të jenë përdorues më të përgjegjshëm të internetit dhe t’i informojmë ata për rreziqet e mundshme të cilat mund ta kërcënojnë sigurinë e tyre. Inkurajimi i fëmijëve për të mësuar më shumë rreth rreziqeve lidhur me keqpërdorimin e informacioneve personale, efektet e sajberdhunës, si dhe pasojat e takimeve me persona të rinj, mund të jenë mekanizma shumë të mirë të vetëmbrojtjes të cilat mund të promovohen nga politikë-bërësit.

Raporti tregon që fëmijët në Kosovë më së shumti e përdorin internetin për argëtim dhe komunikim. Shumica e fëmijëve kanë raportuar se aktivitetet më të pëlqyera në internet janë rrjetet sociale, YouTube, dhe dëgjimi i muzikës. Kur përdorimi i internetit është i limituar vetëm te shfrytëzimi i tepërt i rrjeteve sociale, dobitë e tij mund të kthehen në rreziqe të mundshme për fëmijët. Si pasojë, është e rëndësishme t'i informojmë fëmijët për mënyrat se si mund ta përmirësojnë përdorimin e internetit duke hulumtuar për interesat e tyre apo aktivitetet shkollore. Gjithashtu, është e domosdoshme që fëmijët të informohen për rreziqet që mund të sjellin takimet me të panjohur nga interneti. Kjo është një çështje shumë serioze dhe prindërit, kujdestarët dhe mësuesit duhet të iu japin sa më shumë këshilla fëmijëve në këtë aspekt.

Përfshirja e industrisë së telekomunikacionit është po ashtu shumë e rëndësishme pasi që mund të ndihmojë në mbrojtjen më të mirë të fëmijëve nga rreziqet në internet. Ofruesit e shërbimeve të internetit (ISP) në Kosovë tanimë ofrojnë alternativa për të marrë lidhje të filtruara të pakove të internetit; mirëpo, prindërit dhe mësuesit nuk janë të informuar për këto lloje shërbimesh. Për këtë arsye, ISP-të duhet të informojnë prindërit dhe mësuesit për mundësitë e filtrimit dhe kontrollimit të ueb faqeve të dëmshme për fëmijët. Lidhjet e internetit në shkolla duhet të instalohen direkt me filtra të cilët nuk do t'i lejojnë fëmijët që të kenë qasje në përmbajtje të papërshtatshme.

Jo çuditërisht, shumë çështje të dala nga studimi i bërë lidhen me rritjen e vetëdijes për format e sigurisë në internet, rreziqet e përdorimit të tepërt të internetit dhe grupeve të synuara. Në nivel kombëtar, qeveria është përgjegjëse për kornizën ligjore dhe rregullative sa i përket mbrojtjes së fëmijëve, përmbajtjeve ilegale në internet, mbrojtjen e të dhënave personale, rregullimin e industrisë së telekomunikacionit dhe zhvillimin e politikave adekuate pasi që është institucioni kryesor për ofrimin e sigurisë në internet për fëmijët. Qeveria duhet të inkurajoj dhe financoj më shumë aktivitete për rritjen e ndërgjegjësimit ndaj sigurisë në internet tek fëmijët, mësuesit, dhe prindërit.

Mësuesit po ashtu luajnë një rol të rëndësishëm në edukimin e fëmijëve për sigurinë në internet. Fëmijët kanë raportuar se në përgjithësi mësuesit iu ndihmojnë atyre të identifikojnë rreziqet në internet, mirëpo të njëjtit nuk iu shpjegojnë se çfarë duhet të bëjnë në rast se përballen me përmbajtje shqetësuese në internet. Këto të gjetura duhet të merren parasysh nga politikë-bërësit që të zhvillojnë aktivitete me mësuesit dhe t'i përgatitin ata për mënyrat se si të ju përgjigjen rreziqeve në internet, si të vendosen filtrat e ndryshëm, dhe si të përmirësojnë sigurinë e shfletuesve (browser) dhe faqeve të internetit. Për shembull, politikat që kanë për synim rritjen e vetëdijes shoqërore për sjambërdhunën duhet të përfshijnë edhe mekanizmat e përballimit dhe reagimit ndaj sjambërdhunës për fëmijët. Përveç trajnimit të mësuesve, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë duhet edhe të sigurojë mjete që mundësojnë mësuesit të reagojnë ndaj incidenteve të sjambërdhunës.

Gjithashtu, qeveria duhet të zhvillojë legjislacion për qasjen në faqe me përmbajtje pornografike. Shumë shtete (përfshirë edhe Britaninë e Madhe) kanë zhvilluar ligje të cilat i obligojnë ofruesit e shërbimeve të internetit të zgjedhin nëse dëshirojnë të kenë faqe eksplicite seksuale. Politika të ngjashme mund të zhvillohen edhe në Kosovë.

Në përgjithësi, ka shumë hapa që mund të merren nga secili akter që të përmirësoj sigurinë e fëmijëve në internet në Kosovë. Qeveria, më saktësisht Ministria e Arsimit, Shkencës, dhe Teknologjisë duhet të iniciojë bashkëpunimin në mes të prindërve, mësuesve, industrisë, dhe shoqërisë civile për krijimin e kushteve më të favorshme për përdorimin më të sigurt të internetit. Prindërit dhe mësuesit duhet të jenë më të përfshirë në mbikëqyrjen e aktiviteteve të fëmijëve në internet, kurse industria duhet t'i informojë ata mbi vendosjen e filtrave dhe mundësitë e rregullimit të privatësisë.

Në fund, ne mendojmë që përdorimi i internetit tek fëmijët duhet të përmirësohet dhe jo të kufizohet. Rritja e konsiderueshme e fushatave të ndërgjegjësimit të publikut rreth rreziqeve në internet, investimi dhe përmirësimi në mjetet e sigurimit dhe në përgjithësi njohuria më e mirë e përdorimit të internetit në familje mund të rezultojë në përdorimin më të sigurt të internetit për fëmijët.

# REFERENCAT

- American Academy of Pediatrics (2001). Children, adolescents, and television, [online].
- Bushman, B. & Anderson, C. (2002). *Violent Video Games and Hostile Expectations: A Test of the General Aggression Model*. *Personality and Social Psychology Bulletin*, 28, 1679-1686.
- Center FIT, (2012). Siguria në Internet.
- Convention on the Rights of the Child [1989] (United Nations).
- Cyber Bullying Definition. (2014). In: US Legal, [online].
- Gentile, D. A., Lynch, P., Linder, J. & Walsh, D. (2004). *The effects of violent video game habits on adolescent hostility, aggressive behaviors, and school performance*. *Journal of Adolescence*.
- Internet Watch Foundation, (2012). *Internet Watch Foundation Annual and Charity Report 2012*. Cambridge, UK.
- Kaiser Family Foundation (2010). *Generation M2: Media in the lives of 8-18 year olds* [online].
- Livingstone, S., Haddon, L., Görzig, A., and Ólafsson, K. (2011). *Risks and safety on the internet: The perspective of European children. Full Findings*. LSE, London: EU Kids Online.
- Ravichandran, P. & deBravo, B.F., (2010). *Young Children and Screen Time (Television, DVDs, Computer)*. National Research Center for Women and Families.
- Rideout V, Hammel E. (2006). *The Media Family: Electronic media in the lives of infants, toddlers, preschoolers and their parents*. Menlo Park, CA.
- Smith, A. (2014). 6 new facts about Facebook. [online] Pew Research Center.





Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

316-053.5/.6:004.738.5(047)

Musmurati, Besianë

Siguria e fëmijëve në internet / Besianë Musmurati. -  
Prishtinë : Fit, 2014. – 45 f. : ilustr. ; 30 cm.

Referencat : f. 46

I.Zymeri, Teuta

**ISBN 978-9951-691-00-0**

# SIGURIA E FËMIJËVE NË INTERNET



Këtë publikim mund ta gjeni edhe  
në formë elektronike në adresën:

[www.internetisigurte.org](http://www.internetisigurte.org)